

RREGULLORE "TECHSPACE"

1. Baza Ligjore

Kjo rregullore hartohet në zbatim të VKM-së Nr. 673 dalë 22.11.2017 "Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", si dhe në dobi të mbarëvajtjes së ambienteve të përbashkëta të TechSpace.

2. Qëllimi dhe fusha e veprimit

TechSpace "Mëso/Guxo/Krijo" është një hapësirë, edukimi për teknologjinë, inovacionin dhe shpirtin e sipërmarrjes.

TechSpace është një qendër inovacioni në shërbim të Startup-eve, studentëve dhe individëve të ndryshëm në fushën e teknologjisë dhe informacionit. TechSpace ka për qëllim të mbështesë me hapësira pune, trajnime, mentorime, asistencë dhe udhëzime të gjithë pjestarët e saj, në mënyrë që të ketë sa më shumë produkte në ndihmë të zhvillimit teknologjik.

Çdo gjë që cënon hapësirat, punën dhe aspektin etik të secilit, do të sanksionohet me masë ndëshkimore si më poshtë:

NENI 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Me anë të kësaj rregullore përcaktohen parimet themelore etike dhe rregullat e sjelljes për të gjithë përdoruesit e "TechSpace".
2. Qëllimi i saj është krijimi i ambientit të përshtatshëm në punë për të gjithë personelin dhe përdoruesit, ku do të dominojnë raporte korrekte të bashkëpunimit, respektimit të rregullores në sjellje dhe detyra.
3. Synimi është ndalimi dhe sanksionimi i dukurive negative të cilat dëmtojnë ambientet, interesin e përgjithshëm dhe interesin e Institucionit mikpritës.
4. Rregullat në vijim janë të detyrueshme për të gjithë anëtarët e "TechSpace".
5. Shkelja e parimeve etike dhe rregullave të sjelljes të përcaktuara në të janë të ndaluara dhe do të sanksionohen me masa ndëshkimore sipas ligjeve në fuqi.
6. Nuk lejohet shpërndarja e paautorizuar e informacionit të rezervuar apo konfidencial.
7. Aksesit në Tech Space do të jetë individual, duke u identifikuar kështu nëpërmjet shenjës së gishtit.

NENI 2 AMBIENTI SHËNDETI DHE SIGURA

1. Çdo abuzim, vjedhje, dëmtim apo akt vandal kundrejt burimeve dhe pasurive të institucionit është i dënueshëm
2. Në abuzime dhe akte vandale do të përfshihet por pa u limituar sa më poshtë vijon:
 - Zhgarravitja e tavolinave, abazhurëve dhe e mureve;
 - Dëmtimi i tavolinës së pingpong-ut dhe aksesoreve të tjerë në mjediset e TechSpace;
 - Dëmtimi i xhamave dhe i dritareve;
 - Dëmtimi i dyerve;
 - Dëmtimi i karrigeve;
 - Keqpërdorimi i mjeteve të punës;
 - Keqpërdorimi i ambientit të kuzhinës;
 - Ndotja e ambientit
3. Lejohet përdorimi i Ping-Pong për arsye çlodhjeje, pasi të ketë kaluar një kohë e kosniderueshme pune.
 - Hapësira e lojës në dispozicion për çdo individ nuk më të jetë më shumë se 30 minuta.
 - Në rast mbledhjesh apo konferencash nuk do të lejohet përdorimi i tavolinës së Ping-Pongut.
4. Çdo përdorues i "TechSpace" duhet të përmbahet nga çdo veprim i cili cënon interesin publik dhe sjell dëm, qoftë të madh apo të vogël në këtë institucion.
5. Të gjitha pajisjet, sendet, sistemet dhe furnizimet janë burime që i takojnë vetëm "TechSpace". Për përdorimin e tyre duhet të merret leje tek personat përgjegjës të "TechSpace".
6. Individu gëzon të drejtën për të kryer aktivitetin e tij në ambientet e "TechSpace". Ai duhet t'i zbatojë me përpikmëri rregullat që kanë të bëjnë me çështjet e sigurisë dhe duhet t'i raportojë menjëherë përgjegjësit, drejtpërdrejtë për çdo problem shëndeti dhe sigurie.

NENI 3 SJELLJE RREPTESISHT TË NDALUARA

TechSpace "Mëso/Guxo/Krijo" është një hapësirë edukimi për teknologjinë, inovacionin dhe shpirtin e sipërmarrjes:

1. Ndalohet abuzimi, shpërdorimi dhe keqmenaxhimi i pasurisë së institucionit.
 - Pasuri e Institucionit quhet çdo gjë e prekshme në brendësi të ambientit.
2. Ndalohet shfrytëzimi i mjeteve të TechSpace për interesa të tjera personale jashtë kontekstit dhe objektit të TechSpace, në dëm të saj. Në rast konstatimi të sa më sipër do të merren masat përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Ndalohet diskriminimi mbi bazë race, ngjyre, seksi, orientimi fetar, origjinë kombëtare, origjinë shoqërore, lidhje familjare, gjendje civile, formimi kulturor, moshe, paaftësie fizike, bindje politike etj.
4. Ndalohet shkelja e të drejtave të ndonjë personi apo subjekti të mbrojtur nga e drejta e autorit, sekretit tregtar, patentës ose ndonjë të drejte tjetër të pronës intelektuale, të mbrojtur me ligj apo cdo akti tjetër nënligjor në fuqi.
5. Ndalohet pirja e duhanit, konsumimi i pijeve alkoolike në ambientet e godinës.
6. Ndalohet çdo sjellje jo etike, jo korrekte, e vrazhdë dhe jo humane ndaj njeri-tjetrit.

NENI 4 NDËSHKUESHMËRIA

1. Përgjegjësi për dëmtimet, vjedhjet, aktet vandale, abuzimet dhe keqmenaxhimet e ambientit do të dënohet sipas legjislacionit në fuqi për dëmin material të kryer, si dhe do të procedohet penalisht sipas parashikimeve të Kodit Penal.
 - Ambienti është i survejuar me kamera.